



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilimjenal/Prilimjenal Received/Delivery	21. 09	2023	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtet Prot Appr	Sasia Kantiteta Quantity
	6186/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1061/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1061/2023 të datës 07.08.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga kundër vlerësimit të rezultateve lidhur me konkursin për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa" në Komunën e Rahovecit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1061/2023 e datës 07.08.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Komuna e Rahovecit më datë 08.05.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00011614 për grupin Specialistë të Buxhetit respektivisht për pozitën "Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa", ku afati për aplikim ka qenë nga data 29.05.2023 deri më datë 05.06.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku përmes Listës së kandidatëve fitues me numër protokolli 864 të datës 29.06.2023 të Njesisë së Personelit të Komunës së Rahovecit është njoftuar lidhur me renditjen si i dyti në listë.

Kundër kësaj Liste, ankuesi me datë 29.06.2023 ka parashtruar dy ankesa në Komisionin e Rekrutimit të Komunës së Rahovecit, njëren lidhur me vlerësimin e jetë shkrimit, ndërsa ankesën tjetër lidhur me rezultatin e vlerësimit të intervistës me gojë. Ndërsa Komisioni i Rekrutimit në

Komunën e Rahovecit me Vendimin me numër protokoll 935/2023 të datës 03.07.2023, respektivisht me Vendimin me numër protokoll 948/2023 të datës 04.07.2023 ka refuzuar ankesat e ankuesit si të pa bazuara.

Tutje ankuesi i pa kënaqur me rezultatet e vlerësimit për konkursin me Nr.Reference: RN00011614 për grupin Specialistë të Buxhetit respektivisht për pozitën " Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa", me datë 07.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1061/2023, të regjistruar nën shenjën A.nr.1061/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 09.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Rahovecit. Ndërsa Këshilli me datë 15.08.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:*  
Ankesën me numër protokoll 1061/2023 të datës 07.08.2023 të parashtruar nga ankuesi V.O në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 935 të datës 03.07.2023 të Komisionit të Rekrutimit të Komunës së Rahovecit; Diplomën me numër 1136 të datës 08.02.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës- Fakulteti Ekonomik për V.O; Vërtetimin e kopjes nga origjinali me numër LRP-së 483/2020; Letër reference me numër protokoll 145 të datës 05.02.2020 të Bankës Ekonomike; Letër reference me numër regjistrimi 09-700 të datës 14.09.2015 të ProCredit Bank; Diplomën me numër 058/15 të datës 15.10.2015 të Kolegjit të Menaxhmentit Internacional Programi Kontabilitet dhe Auditim; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.05.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Komunën e Rahovecit; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1031/2023 të datës 15.08.2023 të Komunës së Rahovecit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shpalljen e konkursit me numër reference RN00011614 me datë 08.05.2023 nga Komuna e Rahovecit; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe të refuzuar; Listën e aplikantëve në pritje; E-mailin e datës 15.06.2023 të dërguar nga A.Th për I.M, R.B, E.B, A.TH, Y.K, J.K , S.K dhe V.O; E-mailin e datës 26.06.2023 të dërguar nga A.TH për E.B, A.TH, Y.K, J.K, S.K, I.M dhe V.O; Listën e ngushtë me numër protokoll 710 të datës 07.06.2023; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 27.06.2023; Listën e kandidatëve fitues me numër protokoll 27. të datës 29.06.2023; Vendimin me numër protokoll 945 të datës 04.07.2023 të Komisionit të Rekrutimit të Komunës së Rahovecit; Listën e ngushtë me numër protokoll 768 të datës 12.06.2023; Certifikatën e datës 17-18.11.2022 të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatën muajit maj-qershor 2023 të lëshuar nga "Gërmin"; Certifikatën e lëshuar nga Diplomën me numër 09/23 të datës 02.06.2023 të lëshuar nga Kolegji "Biznesi"- Programi Menaxhment Financa për I.M; Diplomën me numër 1878/14 të datës 17.12.2014 të Kolegjit "AAB"- Programi Menaxhment dhe Informatikë për I.M; Aplikacioni i kandidatit I.M së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 25.03.2008-31.05.2023 të I.M; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 05.06.2023 të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale të Kosovës; Kontratën e punës për kohë të caktuar të lidhur mes Agjencisë për Zhvillim Rajonal dhe I.M; Kontratën e punës për kohë të caktuar të lidhur mes Agjencisë për Zhvillim Rajonal dhe I.M; Aplikacioni i kandidatit V.O së bashku me përgatitjen

profesionale dhe atë të përvojës së punës; Kopjen e letërnjoftimit të V.O; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 30.05.2023 të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale të Kosovës; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 01.01.2019-23.05.2023 të V.O; E-mailin e datës 15.06.2023 të dërguar nga I.M, V.O dhe R.B; Kopjen e letërnjoftimit të I.M; E-mailin e datës 31.07.2023 të A.B për A.TH; Akt emërimit me numër protokolli 1044 të datës 31.07.2023 të lëshuar nga Njësia e Personelit të Komunës së Rahovecit për I.M; Vendimin me numër protokolli 775 të datës 12.06.2023 të Komunës së Rahovecit; Ankesën e datës 29.06.2023 të parashtruar nga ankuesi V.O; Ankesën e datës 29.06.2023 të parashtruar nga ankuesi V.O; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën e punës Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa; E-mailin e datës 12.11.2023 të dërguar nga A.TH për I.M-SH me korrespondim prej faqe 1-7;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, *sepse*:

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se Komisioni i Rekrutimit në Komunën e Rahovecit, më datë 03.07.2023 ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 935, respektivisht me datë 04.07.2023 ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 948 me të cilin i ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit të parashtruar kundër rezultateve të vlerësimit për konkursin me Nr.Reference: RN00011614 për grupin Specialistë të Buxhetit respektivisht për pozitën "Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa", me të cilin vendim ankuesi është njoftuar më datë 04.07.2023 të cilën provë materiale e ka dërguar ankuesi.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 125 paragrafi 1 i cili ka përcaktuar se "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative)".

Tutje Kolegji i Këshillit, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 përcakton se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill është jashtë afatit siç përcaktohet me nenin 127 paragrafi 1 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që në përgjigjen e datës 15.08.2023 respektivisht në deklarinimin e Menaxherit të Burimeve Njerëzore si dhe dëshmitë e dërguara nga vet organi i punësimit respektivisht Komuna e Rahovecit del se ankuesi pas përfundimit të procedurës me datën 29.06.2023 ka parashtruar dy ankesa, ndërsa Kryetari i Komisionit të për Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Rahovecit me datën 03.07.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 935, me të cilin e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesi lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit - biografisë, ndërsa me datën 04.07.2023 Kryetari i Komisionit për Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 948, me të cilin e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesi lidhur me vlerësimin e intervistës me gojë Po ashtu në bazë të dëshmitëve të ofruara gjegjësisht sipas deklarinimit të Menaxherit të

Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit përmes emailit të datës 12.09.2023, ku i njëjti thekson se çdo vendim i marrë lidhur me procedurat e rekrutimit automatikisht përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i'u shkon në e-mail çdo kandidati.

Duke marrë parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, i'u referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ", si rrjedhojë meqenëse ankuesi lidhur me pakënaqësitë e rezultatit të vlerësimit lidhur me konkursin me numër reference RN000011614 për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit me datën 07.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pasafatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda A.nr.1061/2023,**

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

